

K.K.D.G.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 29/21..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 24/05 2021

VENDIM
Nr.24, date 24 /05/2021

PËR

PROBLEMATIKEN E ULJEVE NE DIGEN E HEC MOGLICES

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 24.05.2021 mori në shqyrtim dokumentacionin teknik të paraqitur nga Kompania "DEVOLLI HYDROPOWER" shpk në lidhje me problematiken e uljeve të evidentuara në digën e HEC Moglices si dhe monitorimin e kësaj situatë gjatë kësaj kohe dhe në të ardhmen. Bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur, rezultateve të monitorimit të digës dhe në mënyrë të vecantë të uljeve të evidentuara në digën e HEC Moglices si dhe Analizave të kryera nga ekspertët e Shfrytëzuesit dhe Projektuesit të Digës, KKDM

VENDOSI:

1- Ti kërkojë Kompanisë DEVOLLI HYDROPOWER shpk

- Vazhdimin e monitorimit të digës dhe uljeve të saj në vazhdimësi sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga KKDM gjatë kësaj periudhe. Bazuar në këto të dhëna, Shfrytëzuesi i digës duhet të japë edhe parashikimet e uljeve të digës për të paktën një periudhë 5- 10 vjeçare.
- Kryerjen e një Analize dhe Vlerësimi nga eksperte të kualifikuar të uljeve në digën e HEC Moglices si dhe të qëndrueshmërisë së saj në kushtet aktuale duke u bazuar në të dhënat e monitorimit të kryer nga ekipi i specialistëve të shfrytëzuesit të Digës gjatë periudhës nga fillimi i mbushjes së rezervuarit deri në momentin e përgatitjes së Raportit. Gjatë kësaj analize duhet të merren në konsideratë edhe sjellja e trupit të digës në kushtet aktuale duke marrë parasysh edhe fenomenet që mund të ndodhin gjatë kësaj kohe si rezultat i ndonjë termeti të mundshëm në zonë me magnitudë sipas parashikimeve të dhëna në projekt.
- Hartimin e një Raporti Teknik nga eksperte të kualifikuar dhe me eksperiencë ndërkombëtare në fushën e qëndrueshmërisë së digave dhe të uljeve të tyre. Raporti duhet të jetë i shoqëruar me analizat e kërkuar me siper, me të dhënat e monitorimit për periudhën Mars 2019 – Shtator 2021, konkluzionet përkatëse të grupit të ekspertëve në lidhje me qëndrueshmërinë dhe sigurinë e digës në të ardhmen, masat që parashikon shfrytëzuesi i digës në të ardhmen në lidhje me monitorimin, mirembajtjen dhe sigurinë e digës së HEC Moglice. Raporti duhet të dorëzohet pranë KKDM brenda muajit Nëntor 2021.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

